



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi SHPTSH, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën 12-2158 nga viti 2020, formuar pas denoncimit numër 12-2158/1, me datë 09.06.2020, dorëzuar në adresën elektronike nga parashtruesi SHPTSH, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për vazhdim të mëtutjeshëm në lëndën nr. 12-2158 nga viti 2020.

Lënda me numër 12-2158 nga viti 2020, të mbylet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit, të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin – në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-2158 nga viti 2020 e formuar pas denoncimit numër 12-2158/1 me datë 09.06.2020. dorëzuar deri në Komisionin shtetëror për parandalim të korrupsionit në adresën elektronike nga parashtruesi SHPTSH

Në denoncim tregohet për akuza për dyshime në ligjshmërinë e realizimit të konkursit publik për dhënje në koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit me ujra, shpallur në muajin Maj të viti 2020, gjegjësisht, gjatë kohës të gjendjes së jashtëzakonshme në RMV të shpallur përshkak të pandemisë nga virusi korona.

Parashtruesi kërkon që KSHPK t'i ndërmerr të gjitha masat e veta kompetente, të bënë inspektim në dokumentacionin e tenderit dhe realizimit të konkursit publik të lëndës me qëllim që të ndërpritet dhe të shfuqizohet dhe pastaj të shpallet konkurs i ri në përputhje me rregullativë ligjore dhe nënligjore.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit me ujra për informacione dhe të dhëna në lidhje me rastin e lëndës. Pas kërkesës së Komisionit shtetëror janë dorëzuar informime me informacionet e kërkuara në shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Akuzat e lëndës kanë të bëjnë me dyshime për ligjshmërinë e realizimit të Konkursit publik për shpërndarje të koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit, në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit me ujra (MBMU), me nr .../....., i cili ka qenë shpallur me datë 01.05.2020, gjatë kohës së gjendjes së

jashtëzakonshme në RMV e shpallur përshkak të pandemisë nga virusit korona. Akuzat, konkretisht kanë të bëjnë me lëndën numër 1 nga konkursi i shpallur 1 Zona e peshkimit "Akumulacioni

○ Lëndë e koncesionit në konkursi e shpallur publik ka qenë:

- Zona e peshkimit "Akumulacioni" e cila e tërë sipërfaqen e akumulacionit përveç pjesës afër bregur prej 10 metra (pjesa e caktuar si zonë rekreative) dhe brezi i shënuar rreth kafazëve të vendosur për kultivim të peshqive; dhe
- Zona e peshkimit "Akumulacioni" e cila e përfshinë tërë sipërfaqen e akumulacionit prej 500 metra gjatësi në rrjeshën e ujit nga ura e Drinit të Zi cili gjendet në veri të hidrocentralin "Globoçica" dhe 500 gjatësi në rrjedhë të ujit nga ura në fshatin Kosovrast i Poshtëm, përveç pjesës rreth begut në distancë prej 50 metra dhe brezit të shënuar rreth kafazëve të vendosur për kultivim të peshqive..

Parashtruesi në denoncim tregon për disa rrethana të cilat thelbësisht ndikojnë në realizimin e konkursit publik të lëndës, siç është:

- shpallja e konkursit ka qenë në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme në RMV të shpallur përshkak të pandemisë së virusit korona, gjegjësisht gjatë kohës trazirave shëndetësore, ekonomike dhe shoqërore kur gjendaj e përgjithshme shoqërore në shtet, në mes tjerash edhe peshkimi si e përgjithshme e mirë me interes të veçantë, ka qen i mbrojtur edhe me nenin 56 nga Kushtetuta e RMV.
- Vendimi për shpallje të konkursit publik është marë para mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare pas marrjes së Vendimit për shpallje të zgjedhjeve me datë 19.02.2020, edhe pse në përputhje me dispozitat e ligjit ekziston pengesë ligjore dhe kontraktim të marrëveshjes për koncesione në gjuetisë, kullota, etj
- Konkursi publik përmbanë shumë mangësi dhe paligjshmëri dhe nëse realizohet kështu siç është shpallur, i njëjti realisht nuk mund të zbatohet, gjegjësisht, operativisht dhe praktikisht të përealizueshëm dhe në organizimin e menaxhimit të peshkimit të caktuar ashtu zonë të peshkimit, gjithashtu plotësisht ka qenë e paqartë se në cilën mënyrë do të rregullohen raportet ndërmjet koncesionerit për menaxhim të peshkimit dhe koncesionerit për peshkim rekreativ, si dhe paqartësi si do të menaxhohet gjiret dhe daljet e Liqenit të Tikveshit; dokumentacioni i tenderit ka qenë përgaditur kurse kushtet e parapara për pjesëmarrje në konkurs publik kanë qenë paraparë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga Ligji për peshkim dhe akumulacione; Liqeni i Tikveshit ka pasur koncesionet me detyrë për ruajtje të peshkimit për peshkimin rekreativ dhe është e paqartë çka do të ndodhë me koncesionerin që do të bëjë kontratë në këtë konkurs publik, që don të thotë se realizimi i këtij konkursi publik të shpallur vëndohen në pikëpyetje te siguria e drejtë e koncesionerit.
- Edhe pse konkursi publik është plotë me mangësi dhe paligjësi dhe ka qen në kundërshtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet publik-privat, Ligjin për peshkim dhe akumulacione dhe Ligjin për furnizime publike Ministrina e bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit me ujra, tregoi vendosshmëri në realizimin e të njëjtë, gjë që për parashtruesin jep dyshime të bazuara plotësuere për ligjshmërinë e realizimit të tij.

- Afati i dorëzimit të ofertave pas shpalljes së konkursit ka qenë 16 Qershor 2020, dhe prej këtu kërkohet që KSHPK të vepron urgjentisht dhe të bënë inspektim në dokumentacionin e tenderit dhe realizimit të konkursit publik të lëndës – me qëllim që procedura për të njëjtën të ndërpritet dhe të shfuqizohet konkursi, dhe pastaj të përsëritet procedura dhe të shpallen konkurs i ri publik për dhënje në koncesion në përputhje me respektimin e rregullativës ligjore dhe nënligjore në RMV.

Me qëllim të caktimit të gjendjes faktike për rastin e lëndës, KSHPK deri në MBPU dorëzoi kërkesë për atë se vallë gjatë shpalljes së konkursit publik të lëndës është marrë parasysh se shpallja e tillë është në kohë të gjendje së jashtëzakonshme në RMV e shpallur si rezultat i pandemisë së virusit korona. Në kërkesën e dorëzuar KSHPK i tregon Minsitrisë se ''me fillimin e ndërmarrjeve të aktiviteteve për vazhdimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë kohës së procesit zgjedhor në RMV, dhe Qeveria e RMV dhe gjer në përfundimin e zgjedhjeve të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe zgjedhje së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me rezultatet zgjedhore, instituconet dhe organet në RMV gjatë veprimit të tyre kompetent duhet t'i respektojnë ndalesat e caktuar në nenet 34 dhe 35 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe nenit 8-a dhe 8-b të Kodit zgjedhor''.

- Nga ana e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit me ujra, janë dorëzuar disa lajmërimet në lidhje me kërkesën e KSHPK, në formë të letrës dhe formë elektronike nga të cilat e fundit me datë 16.11.2020, me shtojcë dokumentacion, me të cilën lajmërojnë për:
 - o Me datë 02.07.2020 lajmërohet se procedura e lëndës ka qenë në fazë e evaluimit të ofertave të plota, në bazë të së cilës Komisioni do të dorëzon ftesë për ankantim elektronik deri në subjektet të cilët kanë dorëzuar oferta valide.
 - o Me datë 14.07.2020 informohen se: në përputhje me dokumentacionin e tenderit afati për marrje të Vendimit për zgjedhje të ofertës më të volitshme për konkursin publik thirrje/.... për dhënje të koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit në muajin Maj të viti 2020 është 45 (katërdhjetë e pesë) ditë, duke filluar nga dita e përfundimit të afatit për dorëzim të ofertave. Komisioni për realizim të procedurës për dhënje të koncesionit për procedurën e realizuar deri në Koncedent dorëzon Propozim për zgjedhje të ofertës më të volitshme ose Propozim për shfuqizim të procedurë për dhënjet të koncesionit për mirësinë e interesit të përgjithshëm. Koncedenti në bazë të Propozimit të Komisionit dhe Raportit për zgjedhje të ofertës më të volitshme publikohet në ''Gazetën Zyrtare të Republikë së Maqedonisë së Veriut'' dhe njëherit informohen se për momentin procedura e filluar pas konkursit publik/.... për dhënje të koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit shpallur në muajin Maj të vitit 2020 ka qenë në fazën e përgaditjes të informacionit për realizim të procedurës, e cila do të përmbante propozim-vendime për zgjedhje ose propzim-vendime për ndërprerje të procedurës.
 - o Me datë 16.11.2020, lajmërohen se në lidhje me procedurën e filluar pas konkursit publik të shpallur/.... për dhënje të koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit shpallur në Maj të vitit 2020, Qeveria e

Republikë së Maqedonisë së Veriut në senacën e pestë të mabjtur me datë 22 Shtator të viti 2020 e rishikoi Informacionin për realizimin e procedurës për dhënje në koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit në të cilën është dhënë Propozim-Vendimi për shfuqizim të procedurës për dhënje në koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit akumulacionin "....." dhe Propozim-Vendim për dhënje koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit akumulacionin "....." me çka është përfunduar: 1) të merret Vendim për shfuqizim të procedurës për dhënje në koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit "Akumulacioni" duke pasë parasyshë se zona e peshkimit e shpallur nuk ka dorëzuar asnjë ofertë të pranur dhe Vendimi është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe 2) të mos merret Vendim për dhënje në koncesion të peshqive për menaxhim të peshkimit për qëllime ekonomike në zonën e peshkimit "akumulacioni"

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstaton se rasti i lëndës nga ana e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit me ujra është marrë parasyshë tregimi se nga ana e KSHPK dhe në lidhje me procedurën konkrete për dhënje në koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit nga ana e organeve kompetente dhe është marrë vendim për shfuqizim të procedurës për dhënje në koncesion për peshkim të peshqive për qëllime ekonomike në zonat e peshkimit "Akumulacioni" e cila është lëndë e procedurës së denoncuar. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën është ndërpersë, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 11 Dhjetor të viti 2020 me numër 12-2158/11

Dorëzuar deri te: arkiva dhe parashtruesi

Punoi: J. C., këshilltarë

Miratoi: G. T., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT**
Kyetar: Biljana Ivanovska